



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

PROJEKT – VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, PËR E DËMTIMIT NGA FATKEQËSI NATYRORE, TË BANESË, SHTETASIT SELMAN LACI, FSHATI THEREPEL , NJËSIA ADMINISTRATIVE VËNDRESHË, BASHKIA SKRAPAR .

Në mbështetje të ligjit nr . 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr . 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 86 datë 21.12.2022 “ Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023 -2025 dhe buxhetin e vitit 2025, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj , Kryetari i Bashkisë

PROPOZON :

1 - Të akordojë ndihmën financiare prej 409.504 (katër qind e nëntë mijë e pesë qind e katër) lekë, familjes së **z. Selman Laci** , fshati Therepel , Njësia Administrative Vëndreshë për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore .

2 – Efektete financiare do të përballohen nga fondi i Emergjencave Civile , parashikuar në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Skrapar .

KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË NATYRORE NË BANESËN E Z . SELMAN LACI FSHATI THEREPEL , NJËSIA ADMINISTRATIVE VËNDRESHË, BASHKIA SKRAPAR .

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak , të Bashkisë Skrapar .

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.45/2019 “ Për mbrojtjen Civile”, VKM nr. 139 datë 16.05.2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, me propozim dhe të kryetarit të Bashkisë, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak :

- Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare nga fondi i Emergjencave Civile, në vlerën prej 409.504 (katër qind e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekë . Sipas preventivit të vlerësimit të banesës së shkatërruar nga fatkeqësia natyrore, reshjeve të shumta dhe të dendura të fundit të muajit Mars 2025. Shpërblimi financiar është i pjesshëm .

Sipas proces verbalit të konstatimit të mbajtur në vend, më datën 01.04.2025 banesa është dëmtuar nga reshjet e shumta dhe nga stuhia dhe erërat e forta dhe ka dëmtime të shumta .

Banesa ka pësuar çarje të shumta të mureve. Çatia ka pësuar dëmtime të mëdha . Problemet janë të shumta .

Z Selman Laci është invalid bashkë me bashkëshorten, ka dhe një vajzë që u bën shërbime dy pleqve . Gjendja e tyre ekonomike është shumë e dobët .

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA**

